



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE
CENTAR ZA USLUGU GRA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 01 Nr./Br./No. 13517
Nr. ifaq. 1 Data 20/05
Br. Str. 1 Date 2026
No. Pg.



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 20.05.2026

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesja e Kuvendit me datë: 20.05.2026 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e V-të, të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **29.05.2026**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 04.05.2026.
2. Pyetje legjislativitet drejtuar ekzekutivit.
3. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
7. Propozim vendim për miratimin e raporteve të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
8. Propozim vendim për miratimin e draft planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riadhesuar dhe Integrimin të të huajve në Komunën e Kamenicës 2026-2028.
9. Të ndryshme.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IV-të, e rregullt e Kuvendit të Komunës së Kamenicës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës më datë: 04.05.2026 dhe filloj ora 10:05. Në mbledhje përveç disa delegatëve të kuvendit, të pranishëm tjerë ishin: Shërbimi profesional i kuvendit, drejtor të drejtorive komunale, përkthyesi, zyra e informimit, zyrtar komunal, përfaqësues të OSBE-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Kuvendit të Komunës, znj. Arbnore Beqiraj Fera, e cila për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 27.03.2026.
2. Pyetje legjislativitet drejtuar ekzekutivit.
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën Janar – Mars 2026 (TM1).
4. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare të punëtorëve të NPL “DARDANA” SH.A.
5. Propozim vendim për dhëien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Republikës së Kosovës.
6. Propozim për miratimin e rregullores (KK) nr.-/2026 për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Kamenicës.
7. Propozim vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për PPP “Ecohigjena” (për pjesën publike KRM “Higjena) në Kamenicë.
8. Propozim vendim për faljen e borxhit të pa paguar për shfrytëzimin e hapësirës publike.
9. Propozim vendim për emërtimin e sheshit “Metush Krasniqi”.

10. Propozim vendim për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Kamenicës.

11. Të ndryshme.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, I nderuari Kryetar i Komunës z. Kadri Rahimaj, e nderuara nënkryetare znj. Arta Bajralija, të nderuar anëtar dhe anëtare të Kuvendit Komunal, të nderuar drejtor, monitorues dhe të pranishëm të tjerë mirë se keni ardhur në mbledhjen e IV-të, të rregullt të Kuvendit Komunal për vitin 2026. Ju njoftoj se për shkaqe të pengesave në emailat zyrtare të shumica prej jush, seanca e paraparë të mbahet me datën 30 është shtyer për sot me datë 04.05.2026, njëkohësisht ju lutem të gjithë Asambleistëve që të paraqiten tek IT të Komunës për funksionalizimin e emailave zyrtar, nga sot seancat e ardhshme dhe materialet do përcillen vetëm tek emailat zyrtar. Materialin e keni pranuar dhe kemi korum të mjaftueshëm për hapjen e mbledhjes.

A keni propozime për rend dite ? Fjala për

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit Kryesuese, të dashur asambleistë dhe pjesëmarrës në seancën e IV-të, faleminderit për kontributin. Të nderuar drejtor komunal, e nderuar nënkryetare. Unë kam tri propozime për këtë rend dite që kërkoj mirëkuptimin tuaj që të përfshihen në rend dite dhe miratimin e tyre, propozimi i parë është në formë të rekomandimit për kuvendin komunal ashtu siqë thotë Rregullorja komunale, për ndarjen e çmimit Emblema e Kamenicës për znj. Faruza Kallaba për më gjatë do ta elaburojmë në pikën e rendit të ditës.

Propozimi i dytë ka të bëjë me buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Rregullimi i varrezave në fshatin “Karaqevë e Epërme”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Komunitetit të Lagjes në Karaqevë e Epërme.

Propozimi i tretë ka të bëjë me miratimin e Drafit të Punës së KKSB për vitin 2026, janë tri pika të rëndësishme që edhe kemi çka të bisedojmë, diskutojmë dhe të nevojshme për tu votuar.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, atëherë i hedhim në votim

Kush është Për që këto pika të hyjnë në rend dite?

Për: 15 vota

Kundër dhe Abstenim nuk ka, këto pika hyjnë në rend dite

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, E hedhim në tërësi rendin e ditës në votim,

Kush është për këtë rend dite ?

Për: 16

Kundër dhe Abstenime nuk ka

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga Mbledhja e mbajtur me datë

27.03.2026

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika e parë ka të bëjë me Shqyrtimin dhe Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 27.03.2026

A keni vërejtje apo diskutim rreth procesverbalit, pasi që nuk ka e hedhim në votim

Kush është për miratimin e procesverbalit?

Për 16

Kundër 0

Abstenim 0

2. Pyetje Legjislativi drejtuar ekzekutivit

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi tek pika e dytë pyetje legjislativi drejtuar ekzekutivit, a keni pyetje ? fjala për :

Djellonë Rrudhani – Anëtare e Kuvendit, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, dua ti drejtohem ekzekutivit në mënyrë të përgjithshme, në lidhje me kthimin e përgjigjeve me shkrim ndaj pyetjeve të asambleistëve, a ka afat të caktuar që këto përgjigje të kthehen, pasi që në seancën e kaluar ngrita një pyetje dhe një propozim në lidhje me mbështetjen e familjeve të prekuara me fëmijë me Sindromën Down, më është thënë që do kemi përgjigje me shkrim por deri më tani nuk kam pranuar asgjë, këtë deshta të pyes, faleminderit shumë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për kryetarin

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit Djellona. Komuna e Kamenicës e ka rregulloren për subvencionim edhe Drejtoria për Mirëqenje Sociale dhe Shëndetësi ka një buxhet të alokuar për ti trajtuar rastet në mënyrë ma gjeneroze që kanë probleme shëndetësore, këto raste ndihmohen përmes aplikimit të drejtpërdrejtë për ndihmë momentale siq njihet për persona fizik e në raste të rregullta ndihmohen edhe familje që kanë fëmijë të prekuar me Sindromin Down por edhe familje me probleme të tjera shëndetësore të

rënda. Pra ekziston rregullorja, ekziston buxheti dhe një komision i cili i trajton kërkesat e parashtruara. Faleminderit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje të tjera, fjala për **Lirim Kryeziu- Anëtar i Kuvendit**, Përshëndetje për të gjithë, Kryetar në Roganë kemi problem me ndriçimin publik, rruga ka Xhamia për te Shkolla është pa ndriçimin publik, se për rrugica e degëzime nuk po foli se gjysma janë pa ndriçim.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Lirim. Fjala për **Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës**, Faleminderit Lirim. Kontratë për ndriçimin publik është iniciuar vitin e kaluar e cila përfunduar në organin shqyrtues të prokurimit publik, e aty dihet se ka edhe vonesa e njëjta procedurë është anuluar dhe e njëjta është në shpallje dhe nuk po e di datën e saktë të dorëzimit të ofertave, komuna ka mare një kompani me kontraktua për ndriçimin publik në gjithë territorin. Deri sa NPL Dardana, me buxhetin që kemi ndarë nga Legjislatura e kaluar në vlerë 70.000 euro, të arrij ti zhvilloj procedurat në prokurimin publik për tu pajisur me mjete adekuate dhe makineri që do ndihmojnë më shumë komunën në ndriçimin publik, po besoj që edhe këtë vit do ta kemi sfidues në prokurimin publik. Nga fundi i këtij viti ne parashohim që NPL ti ketë edhe stafin edhe pajiset për rregullimin e poqave elektrik apo trup ndriçues. Faleminderit shumë!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Labinot Skovrqani e pastaj Magbule Kastrati

Labinot Skovrqani – Anëtar i Kuvendit, Përshëndetje për të gjithë. Dua të dijë se ku ka arrit rregullimin e Urës në fshatin Moqar e cila është dëmtuar dhe është hjekur nga vërshimet, a ka ndonjë projekt gati ? Si dhe pyetja tjetër është te Rruga që shpije tek Shkolla “Dëshmorët e Kombit” ka shumë gropa dhe ka shumë ankesa nga prindërit që i kanë fëmijët në atë shkollë.

Magbule Kastrati – Anëtare e Kuvendit, Po ju drejtohem juve Kryetar nëse është e mundur të parashihet ndonjë projekt i cili ka të bëjë me fshatin Shipashnicë e Epërme për ndriçimin publik dhe tretuarin, faleminderit !

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime të tjera? **Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës**, Nuk po e di saktësisht se për cilën urë po flet, Lab. Një pjesë e cila ka qenë si improvizim me gypa e cila është shfrytëzuar edhe si urë, po e merë nga vërshimet edhe më të lehta, ndërsa kontrata aktuale e cila po zhvillon punimet për ndërtimin e urës tranzit të dytë të Kamenicës, që ne i kemi quajjt krahu 2 në atë pjesë që e lidhë

Kamenicën me Berivojcën e ka në projekt edhe në kontratë që kemi nënshkruar ndërtimin e një ure të re, që e lidh Moqaren me pjesën e Kamenicës.

Labinot Skovrqani- Anëtar i Kuvendit, sqaron se pyet për rrugën që është ka varrezat e në Lagjen Malësia rruga që të dërgon në Moqare, është e shkatrruar plotësisht.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, pjesa e Moqares urën që do ta ndërtojmë është tek Pishina Shkodra dhe nuk është tek Lagja Malësia.

Sa i përket gropave në rrugën tek shkolla, ne kemi kompetencë dhe kemi kontratë për mirëmbajtje, po besoj që drejtori do mbaj shënime dhe do intervenojë, po ashtu ne në Maj-Qershor e bëjmë një lloj inventarizimi në bazë të nevojës për intervenim në infrastrukturë publike, ju e dini që në rrugët regjionale neve nuk na lejohet ndërhyrja pasi që ne nuk kemi kompetencë. Në rrugë lokale ne sigurojmë mirëmbajtje dhe jemi përgjegjës ne si institucion lokal. Ndërsa sa i përket fshatit Shipashnicë, saktësisht investimet në ndriçim publik ka paraparë një listë të gjerë të investimeve në shumë lokalitete në vlerë prej 100 mijë euro, ajo se çka mund të them se ka tri vite që ajo se çka përfshihet në infrastrukturë rrugore përfshin gjithë trajtimin e nevojshëm, nga to parësore në ato dytësore që nënkupton se rrugët që do të ndërtohen medoemos me trupat ndriçues. Sa i përket tretuarit është hartuar një paramasë dhe projekt nga Drejtoria për Investime Kapitale, Shipashnicë e Poshtme, vlera e llogaritu e këtij investimi është 200 mijë euro, dhe do shohim mundësin e financimit në të ardhmen sepse buxheti i ndarë nuk mjafton dhe ky vit me këtë buxhet do të ketë destinim ndoshta në lokalitetet e tjera.

3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamneicës për periudhën Janar – Mars 2026 (TM1).

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika e tretë ka të bëjë me Shqyrtimin e Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën Janar – Mars 2026 (TM1). Kemi këtu drejtoreshën e financave për ta prezantuar.

Ardita Dërmaku – Drejtore e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Përshëndetje për të gjithë, sot para jush po e paraqesim Raportin për 3-mujorin e parë për vitin fiskal 2026.

i cili është pregaditur në bazë të dispozitave të nenit 45, paragrafi 45.2, 45.4, dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike. Në komunën tonë gjithsej të hyra vetanë gjatë periudhës Janar-Mars 2026 janë 137,709.34 Euro, ka kanë shënuar një rënie prej 32.14 %, më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishin 202,936.12 Euro, Rënia e të

hyrave ka ardhur si rezultat i mos faturimit të të hyrave nga Tatimit në Pronë sipas njoftimi të Departamentit qendror . Sa i përket Performanca e Shpenzimeve Kategorisë për paga dhe medijtje ato arritën vlerën prej 3,183,112.42 ndërsa gjatë vitit 2025 ato ishin 2,298,906.93 Euro, krahasuar me % janë 38.46%. Sa i përket kategorisë së mallrave ato arritën vlerën prej 226,382.79 ndërsa gjatë vitit 2025 për periudhën e njëjtë ato ishin 554,200.69 Euro.

Shpenzimet komunale kanë shënuar një shpenzim në shumë prej 55,963.58 Euro dhe krahasuar me vitin 2025 në të njëjtën periudhë ka një diferencë prej 5.830.30 euro shprehur në % është 90,60%. Shpenzimet në subvencione dhe transfere në këtë kategori është 44,692.75 dhe shprehur në vlerë monetare 287,452.20 janë më të ulta ngase në vitin 2025 ka pas ekzekutim të vendimeve gjyqësore nga po e njëjta kategori e shpenzimeve, si dhe Shpenzimet kapitale janë njëra nga kategoritë më të rëndësishme të buxhetit komunal për tremujorin e parë kanë arritur vlerën 3,600.00 Euro, ndërsa në vitin 2025 shpenzimet për këtë kategori ishin më të larta. Kjo ishte një përmbledhje sa i përket raportit, nëse keni pyetje urtoni.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime rreth kësaj pike, fjala për :

Granit Berisha – Anëtar i kuvendit, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Kam një pyetje në lidhje me këtë raport, konkretisht tek pjesa e shpenzimeve janë dy zëra njëri me kod 14032 dhe tjetri 14060, kodi i parë është mirëmbajtja e rrugëve lokale, ndërsa kodi i dytë është mirëmbajtja rutinore. Çka nënkuptohet me këto dhe cili është dallimi ? Si dhe kam edhe një pyetje tjetër tek realizimi i projekteve janë tre zëra në titullin Participim me donator, a ka mundësi të dijë se cilat janë këto projekte dhe a është dashur të specifikohen më shumë se çka nënkuptohet me këtë, faleminderit shumë!

Ardita Dërmaku – Drejtore e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, sa i përket pyetjes suaj në lidhje me shpenzimet, mirëmbajtja e rrugëve lokale këtu regjistrohen të gjitha pagesat që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rrugëve lokale, në këtë rast kemi të bëjmë me sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve, ndërsa sa i përket mirëmbajtjes rutinore në këtë kod regjistrohen pagesat e ndryshme për mirëmbajtjen e hapësirave publike, si shembull mirëmbajtja e varrezave, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese e në këtë rast pagesat janë kryer për NPL “Dardana” e cila e ka kryer këtë punë.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Te kodi i participimit është kod gjeneral i prefshim tash e 5 vite, marrëveshjet që nënshkruhen nga zyra e kryetarit, fondet merën nga ky kod, ka të bëjë me projektin e parkut të aventurave i cili është në ndërtim e sipër, ka të bëjë me një projekt i cili është realizuar në fshatin Karaqevë për ndërtimin e disa rrugëve, kryesisht kodet me bashkëfinancim për ndërtimin e tretuareve në Rubovc dhe Bosce, ka bashkëpunime me fondin kosovare të efqiencies me energji dhe projekte të tilla specifike, nëse vlerat specifike në kuadër të këtyre projekteve dëshirojnë mej pa asambleistet ose kuvendi është mirë mej sjell.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për:

Granit Berisha – Anëtar i Kuvendit, Në bazë të kësaj që tha Drejtoresha i bije që NPL “Dardana” i janë ndarë për 3-mujroshin e parë 22.360 euro për punët që ka kryer.

Ardita Dërmaku – Drejtore e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Po, gjatë kësaj periudhe janë paguar 22.360 euro për shërbimet të cilët i kanë kryer, njëherit theksoj se këtu janë paguar edhe do obligime të vitit 2025, nëse doni më hollësisht mund ti sjell listat, vetëm se drejtohuni me një kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Faleminderit drejtore, a keni diskutime të tjera rreth kësaj pike?

4. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare të punëtorëve të NPL “DARDANA” SH.A.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, pika katër ka të bëjë me propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare të punëtorëve të NPL “DARDANA” SH.A. fjala për:

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Një nga punët e mira të Komunës së Kamenicës dhe Kuvendit Komunal është themelimi i NPL “Dardana” e cila po bënë punë jashtëzakonisht të mirë në mirëmbajtjen e hapsirave publike si dhe në interevenime të natyrave të ndryshme sipas nevojës së drejtorive dhe sektorëve të komunës. Në njërin nga datat e themelimit të saj zyrtarisht, ne i vizituam, i takuam dhe i motivuam për punën e tyre minimalisht për punën që ata po e realizojnë, mjetet të cilat Komuna e Kamenicës më herët i ka shpenzuar për qëllime të këtilla zakonisht janë ekzekutu nga operatori privat dhe shpeshherë jo edhe nga ata nga Kamenica, kjo nënkupton që taksa jonë, buxheti i jonë është dalur nga qyteti ynë, në fund nuk ka diqka shumë të keqe, por ka diqka shumë të mirë që Ndërmarrja Publike i merë këto

mjete dhe punëson staf të Kamenicës që nënkupton që taksa e jonë mbetet prap në Kamrenicë, përveq rritjes së punësimit si ndërmarrje, mirëmbajtjen e hapsirave, buxheti ynë mbetet prap në Kamenicë. Për qëllime të motivimit unë kërkoj nga ju si asambleistë ta përkrahni shumën e ndar prej 3000 euro, shumë do të ndahet tek punonjësit duke përjashtuar këtu Bordin e Drejtorëve të NP, punonjësit e tjerë do përfitojnë në mënyrë simbolike. Faleminderit shumë!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime rreth kësaj pike, pasi që nuk ka, e hedhim në votim

Kush është për miratim?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 0, miratohet

5. Propozim vendim për dhëien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Republikës së Kosovës.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi tek pika e pestë e rendit të ditës, Propozim vendim për dhëien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Republikës së Kosovës, fjalën ja japim

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, edhe kjo është një pikë e rëndësishme për të cilin kërkoj miratimin tuaj, ka të bëjë me bashkëpunim ndër institucional mes atij komunal të Policisë, për dhëien në shfrytëzim të objektit AMF ose Ambulances së Mjeksisë, për nevojat e Policisë. Policia ndahet në disa sektore, e njeri prej sektoreve është pika kufitare, vija e gjelbërt raste të cilat ata i kanë gjatë ditës kanë nevoj për trajtimin e tyre dhe kanë nevojë për një objekt më të afërt, duke qenë se ambulanca nuk është në funksion për shumë vite dhe kërkesa e drejtorisë regjinale të policisë ka ardhur drejt nesh, ne e kemi dhënë aprovimin tonë që ky objekt të shfrytëzohet nga policia, dhe kërkohet miratimi i juaj.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime rreth kësaj pike, pasi që nuk ka e hedhim në votim

Kush është për miratimin e kësaj pike ?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 0

6. Propozim për miratimin e rregullores (KK) nr.-/2026 për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Kamenicës.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e gjashtë që ka të bëjë me Propozim për miratimin e rregullores (KK) nr.-/2026 për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Kamenicës, fjalën për këtë e ka Shuajb Lakna nga Personeli.

Shuajb Lakna, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Lidhur me rregulloren për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Kamenicës, kryetari i komunës me vendim përkatës ka formuar grupin punues për hartimin e kësaj rregulloreje. Ky dokument rregullon organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, dokumenti delegon nga statuti i komunës së Kamenicës dhe Ligjit për Zyrtar publik. Komuna e Kamenicës ka zhvilluar të gjitha procedurat për hartimin e një akti të till. Kemi zhvilluar shqyrtimin publik, i kemi marrë të gjitha komentet gjithashtu kemi qenë të obliguar që të njëjtën ta dërgojmë në Departamentin e Menaxhimit të zyrtareve publik në ministrinë përkatëse, për konsultime paraprake i kemi marrë atë si komente dhe i kemi inkuorporuar në këtë rregullore, po ashtu kemi marrë edhe konsultim publik me zyrtar institucional ka pasur kërkesa sa i përket korigjimeve për pozitat e vendeve të punës ku kanë kërkuar modifikime me arsyetimin se duhet të përshtaten kjo rregullore. Në këtë rregullore janë të përfshira detyrat e secilit sektor dhe sistematizimi i vendeve të punës në të gjithë komunën e Kamenicës, ku janë të përfshira e QKMF edhe Arsimit para universitar. Numrat që mund të shihni në rregullore janë punëtor aktual që janë në listën e pagave sipas buxhetit të miratimit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Faleminderit shumë, a keni pyetje apo diskutime rreth kësaj? Fjala për:

Djellonë Rrudhani – Anëtare e Kuvendit, Dua të pyes në lidhje me nenin 21 të kësaj rregulloreje a mund të kemi detaje më të hollësishme ?

Shuajb Lakna, Nëse janë të paraparë në këtë rregullore shembull 2, vitin tjetër nëse ka shtim të buxhetit që miratohet nga Kuvendi, nuk na paraqet problem për me ndryshuar rregulloren vetëm nëse kemi punë me harmonizim apo sistematizim, sa i përket strukturës po, a me numra nuk kemi nevojë me ndryshu këtë rregullore.

Djellonë Rrudhani – Anëtare e Kuvendit, Kjo llogaritet si miratim automatik, nëse miratohet buxheti mund të ketë lëvizje.

Shuajb Lakna, pra nuk është problem numri.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera?

Atëherë pasi që nuk ka diskutime, e hedhim në votim

Kush është për miratimin e kësaj rregulloreje ?

Për: 12

Kundër: 0

Abstenim: 2

7. Propozim vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për PPP “Ecohigjena” (për pjesën publike KRM “Higjena) në Kamenicë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e shtatë e rendit të ditës, Propozim vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për PPP “Ecohigjena” (për pjesën publike KRM “Higjena) në Kamenicë, ky komision formohet nga një anëtar i emëruar nga Kryetari si dhe një anëtar i propozuar nga Kuvendi, që i bije subjektit të parë Lëvizjes Vetëvendosje për të propozuar, a keni propozim ? Kërkon fjalën

Magbule Kastrati – Anëtare e Kuvendit, Sa anëtar të propozohen nga Kuvendi ?

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, vetëm një (1) anëtar, me zvogëlimin e numrit të asambleistëve e kemi një anëtar nga kuvendit dhe një i emëruar nga Kryetari. Shkojmë me propozim, fjala për:

Berat Dërmaku – Anëtar i Kuvendit, Përshëndetje, ne grupi parlamentar i LVV propozojmë Lirim Kryeziu për anëtar të këtij komisioni.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, e hedhim në votim

Kush është për miratim?

Për: 2

Kundër: 0

Abstenim: 2, miratohet

8. Propozim vendim për faljen e borxhit të pa paguar për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jem te pika e tetë e rendit të ditës propozim vendim për faljen e borxhit të pa paguar për shfrytëzimin e hapësirës publike, fjala për:

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Shoqata LUZMA ka adresuar disa kërkesa kundrejt Komunës së Kamenicës dhe Kuvendit Komunal për faljen e borxhit për

shfrytëzimin e hapësirës publike, arsyeja e tyre ka qenë se kjo hapësirë publike nuk është se është shfrytëzuar nga Shoqata e tyre dhe se ky borxh i ngarkuar drejt tyre nga drejtorja përkatëse pothuajse e ka sjell Shoqatën buzë falimentimit për arsyeje që këta nuk kanë mundësi të paguajnë një borxh kaq të lart, arsyeja e dytë është që Shoqata Luzma është privu nga e drejta për aplikim për subvencionim në shumë institucione edhe tonat lokale, ne dimë se rregullorja komunale thekson se secili që dëshiron të përfitoj ndaj një thirrjeje publike, nuk duhet të ketë obligime ndaj atij institucioni. Shoqata Luzma për ne është shumë e rëndësishme dhe besojmë shumë që Shoqata e Bletarëve duhet të jetë funksionale dhe të ekzistoj dhe ne ti japim mundësi atyre të riorganizohen në kuptimin e tyre formal pasi që ata kanë statut të vetin dhe formën e riorganizimit ju takon atyre por të funksionojnë në territorin e Komunës së Kamenicës përmes Shoqatës dhe Institucionit është shumë më lehtë bashkëpunimi ynë dhe po besoj që Bletarët do të jenë të kënaqur me vendimin tonë, andaj ju ftoj që ta përkrahni këtë vendim. Faleminderit !

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime rreth kësaj pike, pasi që nuk ka e hedhim në votim

Kush është për miratimin e kësaj pike ?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 0, miratohet.

9. Propozim vendim për emërtimin e sheshit “Metush Krasniqi”

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi tek pika e nëntë në rend dite, që ka të bëjë me propozim vendim për emërtimin e sheshit “Metush Krasniqi”, fjalën e ka:

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Propozim vendimi për emërtimin e sheshit “Metush Krasniqi” ka ardhur si rezultat i diskutimit në Bordin e Drejtorëve, duke ditur që ajo hapësirë rrugore tani është shndërruar në një hapësirë publike në formate tjetër në shesh, ne konsiderojmë që ta formalizojmë atë që ne e njohim ndër nesh që ky shesh ta bart emrin e njërit nga veprimtarët më të mëdhenj të çështjes kombëtare, me privilegjin më të madhe sot para jush propozoj që sheshi i Kamenicës ta bartë emrin e Heroit Kombëtar “Metush Krasniqi”.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime rreth kësaj pike, pasi që nuk ka e hedhim në votim

Kush është për miratimin e kësaj pike ?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim 0, miratohet

10. Propozim vendim për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Kamenicës.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi tek pika e dhjetë, propozim vendim për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Kamenicës, fjalën e ka

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, është formuar një komision i cili ka pasur për obligim dhe qëllim që të bëjë rifreskimin e listës rezervë të emrave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve në Komunën e Kamenicës. Si proces që është zhvillu nga Komuna e Kamenicës vite më parë nëse nuk gabohem më shumë se dhjetë (10) vite, që është zhvilluar në gjithë territorin e Komunës së Kamenicës ka dal procesi më i mirë i mundshëm, ka pasur ankesa dhe kërkesa të vazhdueshme kundrejt institucioneve tona për ndryshim plotësim të këtyre rrugëve pasi që komisioni atëherë del që ka pasur mangësi të theksuara në emërtimin e rrugëve, shesheve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Kamenicës. Ashtu siqë është përcaktuar në akte tjera ligjore ashtu siqë është paraparë në Udhëzime Administrative dhe Ligjet përkatëse secila komunë ka të drejtë të mbaj një listë rezervë të emrave që mund të shfrytëzohen në të ardhmen në ndonjë rrugë të reja apo të bëhen ndryshime të cilat konsideron të nevojshme, duke parë kërkesat e mëdha por edhe nevojën gjithashtu ne kemi paraparë që Komuna e Kamenicës duhet ta rifreskoj Listën rezervë të emrave të rrugëve dhe më pas në bazë të kësaj liste të shoh mundësin e ndërhyrjes në rrugë të reja apo ekzistuese të ta bëjë ndryshimin e emrit për emërtimin e ndonjë rrugë, andaj komisioni ka përfunduar punën e tij dhe para jush janë disa propozime për të cilat ne besojmë se përkojnë drejt me territorin tonë, vlerat e tona dhe besojmë se janë në përputhje me Udhëzimin Administrativ dhe Ligjet në fuqi, kështqë ne mundemi edhe të diskutojmë, mund të pranojmë dhe propozime mirëpo këto që ju sot keni para vetës është një punë e gjatë e një komisioni komunal i cili është themeluar, faleminderit!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime ? Fjala për:

Faton Jakupi – Anëtar i Kuvendit, Përshëndetje Kryesuese. Unë shpejt e shpejt i lexova emrat e propozuar nga Komisioni dhe kjo e fundit Kallaba është gjallë dhe nuk keni të drejtë ligjore të emëroni rrugë me emra të personave që janë gjallë. E dyta mos ta bastardojmë politikisht rrugët e Kamenicës e që nesër me u ndërruar pushteti mi ndërruar dhe emrat. Edhe këtu ka kriter, duhet që të jetë një aktivist kombëtar një diçka që ligji dhe rregullorja e brendshme e specifikon veprimin e popullit, ju sot mund ta bëni por nesër ndërroheni, çka ka Kamenica lidhje me Astrit Deharin pyetje direkte, jeni ka bëni politika të liga që nesër kush do që vjen në pushtet ti ndërron, për Faruza Kallaba që e keni për ta shpall Qytetar Nderi e meriton është e jona dhe e meriton, a është njeri gjallë e ju doni mi lan emrin rrugës kjo është shkelje që ju jeni duke e bërë, a ka pasur të drejtë komisioni unë nuk e di ju këtë ku e keni bazuar ligjërisht, po mendoj që disa vendime Ad-hoc jeni tu nxit urrejtje ndër kombëtare e që Kamenica nuk e meriton.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit, fjala për:

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Ne konsiderojmë që jemi konsultuar drejtë me Udhëzimet Administrative po besojmë edhe në atë që jemi në korrespondencë të plotë me Komunitat e tjera, ka më shumë shembuj se mund të njohim ne këtu se personi i gjallë ka të drejtë të jetë apo mos jetë pjesë e emërimit të një rruge, ka këtu në Kamenicë emra të rrugëve që personat kanë qenë gjallë, për më tepër edhe Komuna e Prishtinës para dz (2) vitesh ka emëruar rrugën Gjin Xhema një atdhetar që ka vepru shumë në klubin shqiptar trans atlantik në SHBA-s. Ndërsa sa i përket Astrit Deharit ka qenë kërkesa ime direkte kundrejt komisionit, unë besoj që është një kërkesë e drejtë për shkak që edhe ligjërisht ekziston bazë ligjore ashtu siç e thamë që çdo kush që vepron me një aktivizëm politikë institucional, ka kontribute të shquara mund të jetë pjesë e kësaj liste, një student i cili ka avokuar gjatë e drejtë për një institucion më të mirë siç është Arsimi Universitar me shumë kauza tjetra politike e i cili përfundoj tragjikisht brenda institucioneve, unë mendoj që i nderojmë shumë student të tashëm dhe ardhshëm dhe besoj që i motivojmë edhe studentet e ri, Në secilin epokë që ne kemi parë e lexuar e shohim që studentet janë iniciatorët e parë të secilit ndryshim politikë në secilin pol të jetës, dhe besoj shumë që shembujt e tillë mund ti motivojmë edhe studentet e tjerë dhe gjeneratat e reja.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera rreth kësaj pike ? nëse jo e hedhim në votim

Kush është për miratimin e kësaj pike ?

Për: 12

Kundër: 3

Abstenim 1, miratohet

11. Propozim vendim për miratimin e Draft Planit të Punës së KKSB për vitin 2026

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Propozim vendim për miratimin e Draft Planit të Punës së KKSB për vitin 2026, fjala për Fisnik Kastrati koordinator për prezantim **Fisnik Kastrati,** Kryesuese faleminderit për fjalën e dhënë, përshëndetje për të gjithë. Ky draft plan i punës përbehet nga pesë (5) objektiva të cilat janë lehtë të realizueshme dhe pa ndonjë kosto financiare, objektivat janë të zërthyera në aktivitete dhe përcakton se kush çka ka për të kryer, unë nuk kam se çka të shtoj Draft planin e keni para vetës dhe mund të jap sqarime shtesë nëse keni pyetje.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Faleminderit Fisnik, a keni diskutime rreth kësaj pike, pasi që nuk ka atëherë e hedhim më votim

Kush është për miratimin e këtij Draft plani ?

Për: 13

Kundër: 0

Abstenim 2, miratohet

12. Propozim vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Rregullimi i varrezave në fshatin Karaçevë e Epërme”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Komunitetit të Lagjes në Karaçevë të Epërme

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te propozimi tjetër që ka të bëjë me buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Rregullimi i varrezave në fshatin Karaçevë e Epërme”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Komunitetit të Lagjes në Karaçevë të Epërme, fjalën për këtë e ka

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Siç e thash dhe më herët është një bashkëpunim në mes Komunitetit dhe Institucionit të Komunës së Kamenicës, për informim të Asambleistëve të rijnë, bashkëpunimi në mes të institucionit dhe komuniteteve çfarëdo qofshin ato për investime kapitale kërkon miratimin e kuvendit komunal dhe më pas krijohet një kod i ri për brenda kodit të participimit, në këtë rast bëhet fjalë për projektin për rregullimin e hapësirave të varrezave në fshatin Karaçevë e Epërme, vlera e për llogaritur e këtij projekti është 99.848.50

euro, ndërsa Komuna e Kamenicës do të participoj me 72.848.50 Euro, ndërsa Komuniteti ka kontribuar me 27.000.00 euro, këto janë vlera të përlogarita në projekt pas zhvillimit të procedurës tenderuese në e marim edhe shifrat e sakta të këtij projekti, kemi votuar dhe më herët projekte të tilla e po besoj që edhe ky projekt do të gjej mbështetjen e asamblesë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime rreth kësaj pike, pasi që nuk e hedhim në votim

Kush është për miratimin e kësaj pike ?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim 0, miratohet

13. Rekomandim për kuvendin e Komunës së Kamenicës për Ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve të tjera

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e 13-të, e cila ka të bëjë me Rekomandim për Kuvendin e Komunës së Kamenicës për Ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve të tjera, fjala për

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit Kryesuese, kjo është hera e dytë që Kuvendi Komunal bënë ndarjen e çmimeve të nderit, hera e parë ka qenë në vitin e kaluar ku ka pasur disa çmime të ndryshme, ndërsa këtë vit po fillojmë me ndarjen e çmimit “EMBLEMA E KAMENICËS” për znj. Faruza Kallaba. Komuna e Kamenicës ka një rregullore e cila rregullon procedurat për ndarjen e çmimeve të nderit, në atë 5 (pesë) çmime të cilat janë paraparë të ndahen, Kuvendi Komunal ka të drejtë të ndaj çmime por edhe të tërheq çmime të cilat i ka ndarë më herët. Për arsyeje që një zonjë me prejardhje nga Kamenica e cila ka kontribuar gjatë Luftës së Fundit duke qenë pjesë e forcave të armatosura të NATO-s në aviacion, kemi konsideruar se e meriton çmimin “EMBLEMA E KAMENICËS”, dhe komisioni i cili ka shqyrtuar biografin ka aprovuar kërkesën tonë dhe mbetet në dorën e Kuvendit që të ndaj këtë çmim për znj. Faruza Kallaba.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime, fjala për:

Magbule Kastrati – Anëtare e Kuvendit, Faleminderit Kryesuese. Unë mora fjalën pasi që jam Kryesuese e këtij komisioni dhe kërkoj nga e gjithë asambleja pa dallim etnie që të votohet kjo pikë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Magbule, a kemi diskutime të tjera, pasi që nuk ka e hedhim në votim

Kush është për miratimin e kësaj pike ?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 0, miratohet

Të ndryshme

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime në kuadër të pikës të ndryshme, pasi që nuk ka diskutime.

Konstatojmë të mbyllur mbledhjen sotme.

Takimi mbyllet në orën 11:00

Procesmbajtëse


Violeta Krasniqi

Kryesuese e Kuvendit Komunal


Arbnore BEQIRAJ FERA



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të nenit 13, 14, 17, shkronja a), 40 dhe 58, shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja h), nenit 38, paragrafi 38.1, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2026, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë Vendim miratohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për personat fizikë dhe juridikë dhe zhvillimi i procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, në kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi, ndodhen në Zonën Kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", dhe janë të evidentuara sipas certifikatave të pronësisë me numër P-71107041-01339-0 dhe P-71107041-01340-0 në pronësi të Komunës së Kamenicës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7393 m² (shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre metra katrorë), nga të cilat për shfrytëzim jepen 500 m² (pesëqind metra katrorë), në hapësirën e Tregut të Qytetit, pranë objektit të Viva Fresh Store.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale, si dhe sigurimi i të hyrave dhe përfitimeve ekonomike për Komunën nga dhënia e pronës në shfrytëzim me qira.
4. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër, në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh.
5. Prona e paluajtshme objekt i këtij vendimi mbetet në pronësi të Komunës së Kamenicës dhe nuk e ndryshon titullarin juridik. Shfrytëzuesi nuk ka të drejtë ta tjetërsojë, ta japë në nënshfrytëzim personave të tretë, ta ngarkojë me barrë tatimore apo me çfarëdo barre tjetër juridike.
6. Çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, mbi baza vjetore, përcaktohet nga Komisioni për zbatimin e procedurave dhe

vlerësimin e ofertave, në përputhje me Rregulloren komunale në fuqi për Taksat, Tarifat Ngarkesa dhe Gjeba Komunale në Komunën e Kamenicës.

7. Obligohen Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, dhe Diasporë, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, që në bashkëpunim me Komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, të zhvillojnë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, me kontratë të veçantë të përcaktojë të drejtat dhe obligimet ndërmjet Komunës dhe përfituesit të së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale.
9. Procedura për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës realizohet përmes ankandit publik.
10. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në pajtim me nenin 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ – arkiv

Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të nenit 13, 14, 17, shkronja a), 40 dhe 58, shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 17 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja h), nenit 38, paragrafi 38.1, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2026, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, për parcelat e evidentuara sipas certifikatave të pronësisë me numër P-71107041-01339-0 dhe P-71107041-01340-0, në pronësi të Komunës së Kamenicës, për një periudhë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si në vijim:
 - 2.1. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.4. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.5. _____, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, përcaktimi i çmimit fillestar, hartimi i kushteve dhe kriterëve të ankandit publik, zhvillimi dhe administrimi i procedurave të ankandit publik, si dhe vlerësimi i ofertave në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohen anëtarët e Komisionit që gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësiave të tyre të veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Obligohet Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave që, në bashkëpunim me administratën komunale, të zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe procesin e vlerësimit të ofertave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Administrata e Komunës i ofron mbështetje administrative dhe profesionale Komisionit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
7. Kuvendi i Komunës së Kamenicës ruan të drejtën e ndryshimit dhe plotësimit të përbërjes së Komisionit, sipas nevojës.
8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Komisioni dhe organet përgjegjëse të administratës komunale.
